




REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 286/17

Nr. i sq. / Br. st - 5 -

Data: / Datum 28.09.2017

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI

---

**RREGULLORE (KKV) NR.04/2017  
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ANSAMBLIT KOMUNAL TË  
KËNGËVE DHE VALLEVE "HASAN PRISHTINA" NË VUSHTRRI**

Shtator, 2017

Duke u bazuar në nenin 16, pika 1 e Ligjit Nr. 04/L-164 për Ansamblin e Këngëve dhe Valleve “SHOTA” dhe për ansambletë tjera, bazuar në nenin 12, pika 2, shkronja (c) të Ligjit Nr. 03/ L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe nenin 41, pika 2, shkronja (c) të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 28 shtator 2017 miratoi këtë:

**RREGULLORE**  
**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ANSAMBLIT KOMUNAL TË**  
**KËNGËVE DHE VALLEVE “HASAN PRISHTINA” NË VUSHTRRI**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Kjo rregullore përcakton mënyrën e organizimit të aktiviteteve kulturore, artistike, përgatitjen e shfaqjeve, veprave koreografike, këngëve, valleve dhe vlerave të trashëgimisë shpirtërore dhe materiale.

**Neni 2**

**Fushëveprimi**

Me këtë rregullore definohet funksionimi dhe organizimi i Ansamblit komunal të këngëve dhe valleve “Hasan Prishtina” (në tekstin e mëtejme Ansambli), aktivitetet, financimi, pozita e artistëve dhe çështje të tjera të kësaj fushëveprimtarie.

**Neni 3**

**Aktivitetet e ansamblit**

1. Aktivitetet e ansamblit përfshijnë:
  - 1.1. ruajtjen e traditës muzikore kombëtare;
  - 1.2. shfaqjen publike të koncerteve dhe të formave tjera skeniko- muzikore;
  - 1.3. konservimin dhe arkivimin e lëndës muzikore të traditës shpirtërore e materiale, si dhe nxitjen, zhvillimin, avancimin, publikimin dhe promovimin e artit brenda dhe jashtë vendit;
  - 1.4. përgatitjen, ngritjen, promovimin, edukimin mbi traditën e kuadrove të reja përmes studios së vallëzimit.

**Neni 4**

**Organizimi i ansamblit**

1. Struktura organizative e ansamblit përbëhet nga:

- 1.1. drejtori dhe

1.2. këshilli artistik.

### **Neni 5 Financimi**

1. Ansambli financohet nga buxheti i komunës dhe nga të hyrat e realizuara nga koncertet dhe shfaqjet e tij.
2. Ansambli mund të konkurrojë në konkursin vjetor të projekteve kulturore në Ministrinë për Kulturë apo në organizatat tjera që ofrojnë grante ose mbështetje financiare.
3. Ansambli financohet edhe nga burimet tjera (nga donacionet e ndryshme) në pajtim me legjislacionin në fuqi.

### **Neni 6 Përbërja e ansamblit**

1. Staf i udhëheqës artistik:
  - 1.1. udhëheqësi artistik dhe
  - 1.2. koreografi
2. Trupa artistike e ansamblit (si performues të artit) përbëhet nga:
  - 2.1. kori, valltarët, instrumentistët dhe solistët vokal.
3. Staf i udhëheqës dhe trupa e ansamblit punojnë me orar të shkurtuar.

### **Neni 7 Grupet tjera në kuadër të ansamblit**

1. Në kuadër të ansamblit funksionojnë edhe këto grupe:
  - 1.1. grupi i valltarëve fëmijë;
  - 1.2. grupi i valltarëve të rinj;
  - 1.3. grupi i korit fëmijë;
  - 1.4. grupi i korit të rinj;
  - 1.5. grupi i solistëve, dhe
  - 1.6. grupi i instrumentistëve të rinj.
2. Për ushtrimin e grupeve të përmendura si në paragrafin 1 të këtij neni, mund të angazhohen profesionistë të ndryshëm jashtë ansamblit.

3. Angazhimi i profesionistëve të ndryshëm, të përmendur në pikën 2 të këtij neni, realizohet përmes marrëveshjeve që bën drejtori i DKRS-së me ta.

### **Neni 8**

#### **Shfrytëzimi i sallës së vallëzimit**

1. Salla e vallëzimit shfrytëzohet nga:

- 1.1. grupet e valltarëve fëmijë dhe të rinj,
- 1.2. baleti i fëmijëve.

2. Salla e vallëzimit mund të jepet në shfrytëzim me pagesë nga subjektet e tjera.

3. Çmimi për shfrytëzimin e sallës së vallëzimit për një muaj është 40 euro.

4. Shfrytëzimi i sallës së vallëzimit si në paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni realizohet përmes nënshkrimit të kontratës nga drejtori/ja e DKRS-së dhe subjektet tjera të interesuara.

5. Mjetet e inkasuara nga shfrytëzimi i sallës transferohen në xhirollogarinë e komunës.

6. Orari i shfrytëzimit të sallës konform paragrafit 3 të këtij neni, është 12 herë në muaj, për secilën herë nga 90 minuta dhe përcaktohet përmes kontratës.

7. Subjektet e interesuara për shfrytëzimin e sallës së vallëzimit, e që lirohen nga pagesa janë:

- 7.1 performuesit e artit të angazhuar nga institucionet e komunës;
- 7.2 individët dhe grupet vullnetare.

### **Neni 9**

#### **Shfrytëzimi i sallës së orkestrës dhe solistëve**

1. Salla e orkestrës dhe solistëve (si performues të artit) shfrytëzohet për prova të:

- 1.1. instrumentistëve;
- 1.2. solistëve;
- 1.3. orkestrës së fëmijëve dhe të rinjve;
- 1.4. korit të fëmijëve dhe të rinjve, si dhe
- 1.5. grupeve tjera.

2. Salla e orkestrës dhe solistëve mund të jepet në shfrytëzim me pagesë nga subjektet e tjera.

3. Çmimi për shfrytëzimin e sallës së orkestrës dhe solistëve për një muaj është 15 euro.

4. Shfrytëzimi i sallës së orkestrës dhe solistëve si në paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni, realizohet përmes nënshkrimit të kontratës nga drejtori/ja e DKRS-së dhe subjektet tjera të interesuara.

5. Mjetet e inkasuara nga shfrytëzimi i sallës transferohen në xhirollogarinë e komunës.

6. Orari i shfrytëzimit të sallës konform paragrafit 3 të këtij neni, është 12 herë në muaj, për secilën herë nga 90 minuta dhe përcaktohet përmes kontratës.

7. Subjektet e interesuara për shfrytëzimin e sallës së orkestrës dhe solistëve, e që lirohen nga pagesa janë:

7.1 performuesit e artit të angazhuar nga institucionet e komunës,

7.2 Individët dhe grupet vullnetare.

#### **Neni 10**

##### **Pjesëmarrja e ansamblit në organizime brenda dhe jashtë shtetit**

1. Ansambli e përfaqëson qytetin në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Pjesëmarrja e ansamblit në organizime tjera jashtë vendit mund të realizohet nëse i njëjti siguron mjete financiare nga burimet e ndryshme.

#### **Neni 11**

##### **Bashkëpunimet e ansamblit**

1. Ansambli ka të drejtë të bashkëpunojë edhe me ansamble tjera brenda dhe jashtë shtetit.
2. Ansambli fton bashkëpunëtorë (instrumentistë, solistë, valltarë etj.) nga jashtë, për organizime të ndryshme, pagesa e të cilëve rregullohet me vendim të veçantë të kryetarit të komunës.

#### **Neni 12**

##### **Përgjegjësit për zbatimin e kësaj rregulloreje**


Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohet ansambli, ndërsa monitorimin e zbatimit të saj e bën DKRS-ja.

#### **Neni 13**

##### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

**Shpëtim Zhegrova**

  
**Kryesues i Kuvendit**